



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika (d), lidhur me nenin 17 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 10, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013" e konform Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.01/2018, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregullues të hollësishme dhe neneve 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

Neni 1

Me këtë vendim lejohet iniciimi i procedurave për hartimin e **Planit Rregullues të Hollësishëm për "Zonën Industriale" në Biraq** me sipërfaqe të përgjithshme prej 110.91ha.

Neni 2

Planet Rregullues të Hollësishëm, përcaktojnë kushtet për rregullim e hapësirave urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Plan Zhvillimor Komunal për periudhën 2021-2029 dhe Hartën zonale të Komunës së Suharekës për periudhën 2022-2030.

Neni 3

Bartës për procesin e hartimit të **Planit Rregullues të Hollësishëm për "Zonën Industriale" në Biraq**, është Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Suharekës.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm për "Zonën Industriale" në Biraq, mbulon një periudhë së paku 8 (tetë) vite.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI